



Kuvendi i Komunës Klinë

Komiteti Konsultativ për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Mbrojtje të Mjedisit

01Nr. 06-24333 / 2021

Klinë, me: 27.07.2021

PCESVERBAL

Nga mbledhja e -II- për vitin 2021 e Komitetit Konsultativ për Bujqësi Zhvillim Rural dhe Mbrojtje të Mjedisit i mbajtur më datë: 27.04.2021 në sallën e Kuvendit të Komunës duke filluar nga ora 14:00

RENDI I DITËS

- 1. Arsyetimi i mungesave**
- 2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar**
- 3. Informata për bujqit në kohë pandemie, përkrahja e bujqve**
- 4. Të ndryshme,**

Pjesëmarrës në mbledhje ishin anëtarët:

1. Martin Rustemi, Kryesues,
2. Luan Berisha,
3. Shqipe Desku
4. Fahredin Gashi,

Mbledhjen e hapi Kryesuesi Martin Rustemi i cili përshëndeti të gjithë anëtarët e Komitetit Konsultativ për Bujqësi Zhvillim Rural dhe Mbrojtje të Mjedisit.
Prezantoj rendin e ditës:

Pika 1. Arsyetimi i mungesave

Mungoj anëtari Rilind Morina. Kryesuesi theksoj se për shkak të pandemisë do ti amnistojmë edhe ata që mungojnë duke marrë për bazë situatën të cilën gjendemi!

2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar.

Martin Rustemi, kryesues: Nëse ka dikush diçka rreth procesverbalit urdhëroni?! Pasi askush nuk kishte diçka, kryesuesi hodhi në votim dhe me vota unanime u miratua procesverbali nga mbledhja e kaluar.

Pika 3. Informata për bujqit në kohë pandemie, përkrahja e bujqve

Kryesuesi Martin Rustemi: Nëse dëshiron dikush fjalën rreth kësaj pike urdhëroni?!

Unë sa për informatë, ju informoj se kemi biseduar rreth kërkesave të tyre dhe përkrahjen që është dashur ti japim në si institucion komunal. Komuna për këtë na ka përkrahur dhe ndihmuar në çdo fushë, ka pasur disa ankesa për ndarjen e subvencioneve por kanë qenë të pakta, unë i kam sugjeruar që tu drejtohen me ankesë në secilin institucion i cili ka bërë ndarjen e tyre. Ne krejt çka mund të bëjmë është që ti këshillojmë.

Z. Luan Berisha: Mendoj se ka qen mirë të informohemi ne si komitet për mbarëvajtjen e ndarjes së subvencioneve dhe të kemi informata se kush çka ka përfituar!

Z. Martin Rrustemi, kryesues: Nëse ju pajtoheni, ne mund të bëjmë një kërkesë dhe në çdo shpërndarje të jemi pjesë e komisionit edhe ne.

Znj.Shqipe Desku: Martin këto subvencionime të cilat janë ndarë a janë si rezultat i punës sonë si komitet apo janë paraparë nga drejtoria e bujqësisë që të realizohen? Po me intereson a kemi dërguar ne ndonjë rekomandim, a të kanë pyetur ty ndonjë gjë?

Z. Martin Rrustemi, kryesues: Jo nuk kam pasur bisedime me drejtorin për shpërndarjen e subvencioneve, mua nuk me ka pyetur askush!

Z. Fahredin Gashi: Drejtori ka qen njëherë në mbledhje të komitetit dhe na ka informuar, mendoj se po ta ftojme prap do të vije.

Znj.Shqipe Desku: Mendoj se po të ja dërgojmë një ftesë, drejtori do të ishte prezent por edhe nëse nuk mund të jetë ndonjëherë është normale kjo për shkak të obligimeve tjera.

Z. Martin Rrustemi, kryesues: gjithsesi nëse edhe ju pajtoheni ne do ta caktojmë mbledhjen e ardhshme një pikë të rendit të ditës, ku do të jetë prezent edhe Naser morina drejtor i bujqësisë që t'na informoj me gjer rreth subvencioneve dhe punëve të tjera që kryhen nga kjo drejtori. Sa i përket informatave kryetari personalisht na ka përkrahur dhe gjithmonë me ka mbështetur rreth kërkesave që kam pasur.

Kryesuesi, nëse ka dikush ndonjë gjë për te shtuar urdhëroni?! Nëse jo unë me kaq po e përfundoj këtë mbledhje, ju falënderoj për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoj në ora 14:40.

Procesmbajtës,
Ahmet Berisha



Kryesues,
Martin Rrustemi

